

EPISTAXIS

UNIVERSITETI I TIRANES  
FAKULTETI I MJEKESISE  
DEPARTAMENTI ORL-OKULISTIKE  
SHERBIMI ORL

## EPISTAXIS

(HISTORIKU, ANATOMIA DHE FIZIOLOGJIA, ETIOLOGJIA, TRAJTIMI I  
URGJENCES, KIRURGJIKAL DHE JOKIRURGJIKAL.)

PERGATITI : Dr. Holta SULAJ

DREJTOI: Prof. Asc. Dr. Ylli SALLAVACI

## EPISTAXIS

Epistaxis është percaktuar si një hemorragji akute nga flegrat e hundës, hapsira e hundës ose nasofaringsi. Është një urgjencë e shpeshtë. Jo rrallë shkakton një shqetësim të madh tek pacientët dhe klinikistët. Megjithatë me shumë se 90% e pacientëve që paraqiten me epistaxis, mund të trajtohen në mënyrë të suksesshme që në repartin e urgjencës.

### PAK HISTORI

Epistaxis vjen nga greqishtja (dmth. gjak nga hunda). Është një problem që ka qenë pjesë e eksperiencës njerzore që në kohët më të lashta. Shpeshësia e tij ka qenë subjekt i folklorit dhe i miteve. Trajtimi i epistaxisit është bërë që në kohët më të hershme.

**Magjistaret**, "mjekët e lashtësisë", shkruanin fjalë magjike në ballin e pacientit me gjakun e tij, dhe i kërkonin të semurit të mbante hajmali në ngjyrë të kuqe.

**Hipokrati** komentonte që shterngimi i forte i hundës pakson rrjedhjen e gjakut.

**Carl Michel** (1871), **James Little** (1879), dhe **Wilhelm Kiesselbach** ishin të parët që identifikuan plexusin e septumit nazal inferior, si një burim i gjakderdhjes nga hunda.

**Pilz** ishte i pari që trajtoi epistaxisin në mënyrë kirurgjikale me anën e ligatures së arteries Carotis Communis (me 1869).

**Seiffert** ligoi a. maxill interne nepermjet sinusit maxillar (me 1928).

**Henry Good Year** realizoi për herë të parë ligaturën e arteries ethmoidalis ant. si mënyrë për trajtimin e epistaxisit... (1)

Njohuritë e komunitetit mjeksor për epistaxisin janë rritur në mënyrë dramatike. Trajtimi i tanishëm, (edhe pse ka modifikuar disa gjera gjatë viteve), vazhdon të përfshijë teknika të vërtetura për herë të parë gjatë këtyre qindra viteve.

### ANATOMIA DHE FIZIOLOGJIA

Cdo zgavër e hundës kufizohet nga *muri lateral*, që përbehet nga 3 konkat dhe sistemi kompleks i ostiumeve të sinuseve dhe fosave, si dhe nga septumi i hundës *medialisht*).

*Perpara* dhe *prapa* kufizohet nga naret dhe koanat. *Çatia* (tavani i hundës) formohet nga pllaka (lamina) cribriforme dhe nga fovea ethmoidalis, ndërsa *dyschemeja* përbehet nga kocka maxillare... (1).

- Hapsira e hundës është e veshur nga **epiteli ciliar i pseudostratifikuar** dhe **gjendrat sekretore seroze e mukoze**. Një *rrjet vaskular* i pasur ndodhet (kalon) nën këto shtresë të holle mukoze. *Indi erektil* i hundës përbehet nga një numër i madh i sinuseve venoze, anastomozave arterio-venoze dhe venulave. Shumë enë arteriale të ushqyera nga presioni i lartë i sistemit karotid rrjedhin përmes hundës.

**Mukoza respiratore me rrjetin vaskular që ndodhet nën të, shërben për të rregulluar shkëmbimin e nxehtësisë dhe lagështimin e ajrit gjatë respiracionit...**(1).

Hapsira e hundës është jashtëzakonisht e vaskularizuar. Gjaku vjen nga sistemi karotid intern dhe ekstern.

- Dega e parë intrakraniale e a. *carotis int.* është a. *ophtalmicae* që jep: a. ***ethmoidalis ant. et post.*** Këto struktura rrjedhin medialisht, dhe kryqëzohen çatine e hapsirës së hundës, duke ushqyer pjesën e sipërme të septumit dhe murin lateral të hundës... (1).

**Art. ethmoidalis ant.** është zakonisht më e gjera. Ajo vendoset në kanalim me të njëjtin emër, hyn në hapsirën e hundës në nivelin e pjesës së përparshme të lamina cribrosa, dhe ndahet në degët interne (regjioni olfaktiv ant. i septumit të hundës), dhe externe (regj. mbi dhe prekonkal, celulat ethmoid. ant. dhe sinusi sphenoidal)... (3).

Only two pages have been converted.  
Please go to <https://pdfburger.com> and sign up to convert all pages.